



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PËRMET
KËSHILLI BASHKIAK**

V E N D I M

Nr. 34 datë 07.05. 2026

**PËR NJË NDRYSHIM NË VKB NR.124 DATË 17.12.2025 “PËR MIRATIMIN
E MENUVE DHE KUOTËS USHQIMORE, PËR OFRIMIN E VAKTEVE
USHQIMORE NË KUADËR TË PROJEKTIT «PËRQAFIMI I SHPRESËS NJË OAZ
PËR ATA QË KANË NEVOJË»**

Bazuar në Ligjin Nr .139/2015 datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore“, Ligjin Nr 9936, date 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, Ligjin Nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, Ligjin Nr. 68/2017 “Per financat e vetqeverisjes vendore”, Ligjin Nr.115/2024“Për buxhetin e vitit 2025”; VKB Nr.79 datë 23.10.2024 “Për miratimin e Planit Social 2024-2027 për Bashkinë Përmet, Marrëveshjen Nr.72 Prot. datë 13.01.2024, midis Shërbimit Social Shtetëror dhe Bashkisë Përmet, në zbatim të projektit «Përfaqimi i shpresës, një oaz për ata që kanë nevojë»; VKB Nr.124 datë 17.12.2025 “Për miratimin e menuve dhe kuotës ushqimore në kuadër të projektit “Përfaqimi i shpresës një oaz për ata që kanë nevojë”, VKB Nr.16 datë 24.02.2026 “Për njohjen me buxhetin e alokuar nga Fondi Social per zbatimin e projektit “Përfaqimi i shpresës, për ata që kanë nevojë” viti 2026 dhe bashkëfinancimi i Bashkisë Përmet”, shkresë Nr.4354 prot date 31.12.2025 për kryerjen e shërbimit të prokurimit Operatorit të Blerjeve të Përqëndruara; Këshilli i Bashkisë, me propozim të Kryetarit të Bashkisë:

VENDOSI:

1. Kuota ushqimore mesatare javore për ofrimin e shërbimit një vakt ushqimor në kuadër të zbatimit të projektit “Përfaqimi i shpresës një oaz për ata që kanë nevojë” me çmimet e reja është në vlerën 215.36 lekë nga 240 lekë që ishte miratuar më parë pra me një efekt ulje 24.64 lekë.
2. Shpenzimet për blerjen e ushqimeve të përballohen nga buxheti i projektit dhe pjesa e bashkëfinancimit nga buxheti i bashkisë për vitin 2026.
3. Diferenca 24.64 lekë sipas cmimeve të reja do të zbritet nga secili bashkëfinancues aq % sa është zbritja nga fondi limit.
4. Efektet e zbatimit të këtij vendimi do të nisin që prej lidhjes së kontratave me secilin Operator Ekonomik për secilin lot.



Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Sektori Juridik, Drejtoria e Buxhet-Financë, Drejtoria e Përfshirjes Sociale, Arsim-Kulturë, Sporte dhe Drejtoria e Projekteve.

6. Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6, të nenit 55, të ligjit nr. 139/2015, "Për vetëqeverisjen vendore", (i ndryshuar).

Sekretari i Këshillit Bashkiak
Aleks TANE

KRYETAR
Dhimitri

